



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE**  
**SEKTORI MËSIMOR & KURRIKULËS, INFORMIMIT TË STUDENTËVE,**  
**KËSHILLIMIT TË KARRIERËS DHE ALUMNI**

*Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave rome dhe egjiptian, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë.*

<b>Viti Akademik 2023-2024/ Kreu V</b>		<b>Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit</b>
1.	<b>Kreu V, pika 1</b> Kandidatët nga Republika e Kosovës me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e pakicave rome dhe egjiptian, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-të.	<b>02.09.2023 – 13.09.2023</b>
2.	<b>Kreu V, pika 2</b> Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi aplikojnë pranë IAL-ve respektive deri më datën e përcaktuar në kalendar.	<b>13.09.2023</b>
3.	Konkurset e pranimit do të zhvillohen në datën e përcaktuar në kalendar.	<b>16.09.2023</b>
4.	<b>Kreu V, pika 10</b> IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre, si dhe për çdo program studimi që ofrojnë, ato publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. Gjithashtu IAL-të në datën e përcaktuar, publikojnë në mjedise të dukshme të fakulteteve, dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	<b>18.09.2023</b>
5.	<b>Kreu V, pika 12</b> IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e fakulteteve, në datën e përcaktuar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.	<b>26.09.2023</b>
6.	<b>Kreu V, pika 13</b> Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar.	<b>26.09.2023 - 03.10.2023</b>
8.	<b>Kreu IV, pika 14</b> IAL-të brenda datës së përcaktuar në kalendar, sekretarët mësimorë të fakulteteve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.	<b>Pas datës: 04.10.2024</b>
9.	<b>Kreu V, pika 15</b> IAL-të brenda datës së përcaktuar në kalendar, përfundojnë të gjithë regjistrimin e kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.	<b>10.10.2023</b>